



KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

PROCES VERBAL

Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejës për muajin Shkurt 2025

Data 26.02.2025 ora 14:00.

Mbledhja zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat.

Rendi i dites:

- 1.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes datë 29.01.2025 dhe informacion për VKB-të e marra në këtë mbledhje.
- 2.Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Janar 2025.
- 3.Projekt vendim për ndryshim Vkb nr.97 datë 30.12.2024”Për shtesën e transfertes së pakushtëzuar të Bashkisë Vau Dejës sipas aktit normativ nr.5 datë 19.12.2024”.
- 4.Projekt vendim për miratimin e subvencionit të qirasë dhe vlerën e përfitimit për Z.Bujar Ferizolli dhe znj.Elinda Berisha në programin e strehimit “Subvencioni të qirasë në tregun e lirë”.
- 5.Projekt vendim për miratimin e vazhdimësisë dhe vlerën e përfitimit për Z.Pjeter Zefi, Z.Paulin Bisha dhe Znj.Tone Pjetraj në programin e strehimit “Subvencionit të qirasë në tregun e lirë”.
- 6.Projekt vendim për pranimin e të moshuares Znj.Lulë Nika në qendren e përkujdesit rezidencial për të moshuar “Besa” Barbullush.
- 7.Projekt vendim për pranimin e të moshuares Znj.Ganxhe Lukani në qendren e përkujdesit rezidencial për të moshuar “Besa” Barbullush.
- 8.Projekt vendim për dhënien në përdorim me afat deri në 9 vjet për ndërtim/përdorim rruge për lidhjen e sipërfaqes së dhënë në përdorim, me rrjetin rrugor ekzistues me gjatësi 0.280 km rrugë kalimi në ngastra nr.98 në ekonominë pyjore Shosh 2:1.
- 9.Projekt vendim për dhënien e ndihmes financiare të menjëhershme familjes së shtetasit Xhevahir Kol Gjoka, i dëmtuar nga erërat me intensitet të lartë të dt.12.01.2025, banorë i Bashkisë Vau Dejës.
- 10.Relacion spjegues mbi korigjimin e Vkb nr.5, pika3,Vkb nr.6 pika 5 dhe Vkb nr.7 pika 3, datë 29.01.2025
- 11.Të ndryshme.

Grupe interesi nuk kishte prezent në mbledhje.Votimet do bëhen të hapura.

Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejes për muajin Shkurt 2025, u zhvillua me datë 26.02.2025 ora 14.00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat. Fillimisht u bë apeli i këshilltarëve që ishin prezent në sallë, nga ana e sekretarit të Këshillit Bashkiak, Z.Ardian Çelepija.



Të pranishëm në sallë ishin 21 këshilltarë, (Franga Kola, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj, Roberto Trushi, Frano Prenga, Albina Livadhi, Ervis Shimaj, Rita Preçi, Ornela Lleshi, Mirela Vasija, Sanije Salja, Meliha Zyberaj, Mark Bisha, Martin Mardoda, Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Aleko Dodani, Marin Dodaj, Gjon Marku, Rregjinë Shelqetja, Vijoletë Markolaj) korum i mjaftueshëm për të zhvilluar mbledhjen e këshillit.

Fjalën për të filluar mbledhjen e mori Z. Ervis Shimaj-kryetar i këshillit bashkiak i cili lexoi rendin e dites dhe pyeti këshilltarët nëse ishin dakort me rendin e ditës. Këshilltarët shprehen dakortësi. Z. Ervis Shimaj e hedh në votim rendin e ditës: **Miratohet me 21 vota Pro.**

Z. Ervis Shimaj lexon piken e parë të rendit të ditës:

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes datë 29.01.2025 dhe informacion për VKB-të e marra në këtë mbledhje.

U pyeten këshilltarët nëse ishin dakort me procesverbalin e mbledhjes së datës 29.01.2025 nga Z. Ervis Shimaj. Këshilltarët nuk kishin pyetje dhe të gjithë shprehen dakortësi për miratimin e tij. Këshilltarëve ju spjeguan arsyet e kthimit nga Institucioni i Prefektit Qarkut Shkodër. për vendimet nr.5,6,7 ku kërkohet të bëhet korrigjimi i mbulimit të pagesës së dëmëve me buxhetin e vitit 2025 dhe jo me buxhetin e vitit 2024.

Z. Ervis Shimaj lexon piken e dytë të rendit të ditës:

Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Janar 2025.

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Znj. Elidona Lisi -perfaqesuese e zyres se ndihmes ekonomike, e cila relaton lidhur me projekt vendimin e paraqitur. Ajo shprehet se bazuar ne fondet e kushtëzuara për muajin Janar 2025, te perfitojne 132 familje, me 466.123 leke, me 5.98% e fondit total. Në total për Bashkinë Vau Dejës, për muajin Janar 2025 janë shpallur fitues, 1.001 familje, me fond 7.772.785 lekë, nga ku 6% e këtij fondi është 466.367 lekë.

Z. Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z. Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 20 vota Pro. zero kundër dhe zero abstenim.** (Znj. Mirela Vasija nuk merr pjesë në votim)

Këshilltarët që votuan Pro piken e dytë të rendit të ditës: (Franga Kola, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj, Roberto Trushi, Frano Prenga, Albina Livadhi, Ervis Shimaj, Rita Preçi, Ornela Lleshi, Sanije Salja, Meliha Zyberaj, Mark Bisha, Martin Mardoda, Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Aleko Dodani, Marin Dodaj, Gjon Marku, Rregjinë Shelqetja, Vijoletë Markolaj)

Z. Ervis Shimaj lexon piken e tretë të rendit të ditës:

Projekt vendim për ndryshim Vkb nr.97. datë 30.12.2024”Për shtesën e transfertes së pakushtëzuar të Bashkisë Vau Dejës sipas aktit normativ nr.5 datë 19.12.2024”.



Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Znj.Elsa Tanushi- Drejtore e zyres financë buxhetit pranë Bashkisë Vau Dejës e cila spjeron se Këshilli Bashkiak me datë 30.12.2024, ka marrë vendimin me nr.97 për transferten e pakushtezuar të Bashkisë Vau Dejës sipas aktit normativ nr.5 datë 19.12.2024”, vendim i konfirmuar nga Institucioni i Prefektit Qarkut Shkodër, mirëpo vërehet se sipas relacionit të zyres financës pranë Bashkisë Vau Dejës, Bashkia Vau Dejës nuk ka detyrime të prapambetura me fondet e veta dhe kërkohet që shtesa e transfertes së pakushtezuar të Bashkisë Vau Dejës sipas aktit normativ nr.5 datë 19.12.2024, të shpërndahet në programin 04520 të rrjetit rrugor rural për projektin “Sistemim, asfaltim rrugët e brendshme Stajkë” nbikqyrje “Kolaudim” në llogarinë ekonomike 231.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 19 vota Pro.zero kundër dhe 1(një) votë abstenim-Z.Gjon Marku.**(Z.Marin Dodaj nuk merr pjesë në votim)

Këshilltarët që votuan Pro piken e tretë të rendit të ditës: (Franga Kola, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj,Roberto Trushi, Frano Prenga, Albina Livadhi,Ervis Shimaj, Rita Preçi,Ornela Lleshi, Sanije Salja, Meliha Zyberaj, Mark Bisha, Martin Mardoda,Ermir Tahiri,Kastriot Shkjau, Aleko Dodani,Mirela Vasija, Rregjinë Shelqetja, Vjioletë Markolaj)

Z.Gjon Marku votoi abstenim, ndersa Z.Marin Dodaj nuk mori pjesë në votim.

Z.Ervis Shimaj lexon piken e katërt të rendit të ditës:

Projekt vendim për miratimin e subvencionit të qirasë dhe vleren e përfitimit për Z.Bujar Ferizolli dhe znj.Elinda Berisha në programin e strehimit “Subvencioni të qirasë në tregun e lirë”.

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Z.Edmond Gjeçaj-përfaqesues i zyres mbrojtjes,përfshirjes dhe strehimit social, i cili relatton për këshilltarët se të dy familjet rezultonin të pastreha dhe pa të ardhura të mjaftueshme për të përballuar një shtëpi me qira dhe shpenzimet jetike.Nga ana e komisionit të strehimit i ngritur me Vkb nr.80 datë 30.10.2023 për miratimin e ndryshimit të Vkb nr.33 datë 28.04.2023 për ngritjen e komisionit të strehimit, në mbledhjen e dates 12.02.2025, është bërë shqyrtimi i dokomentacionit të paraqitur dhe kontratave të qirasë noteriale për të dy banorët e sipërpërmendur.Komisioni i strehimit ka vlerësuar se Z.Bujar Ferizolli dhe znj.Elinda Berisha të jenë përfitues në programin e strehimit “Subvencioni të qirasë në tregun e lirë”.Vlera e subvencionit të qirasë llogaritet sipas VKM nr.362 datë 20.05.2019.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 21 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim.**



Këshilltarët që votuan Pro piken e katërt të rendit të ditës: (Franga Kola, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj, Roberto Trushi, Frano Prenga, Albina Livadhi, Ervis Shimaj, Rita Preçi, Ornela Lleshi, Mirela Vasija, Sanije Salja, Meliha Zyberaj, Mark Bisha, Martin Mardoda, Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Aleko Dodani, Marin Dodaj, Gjon Marku, Rregjinë Shelqetja, Vijoletë Markolaj)

Z. Ervis Shimaj lexon piken e pestë të rendit të ditës:

Projekt vendim për miratimin e vazhdimësisë dhe vlerën e përfitimit për Z. Pjeter Zefi, Z. Paulin Bisha dhe Znj. Tone Pjetraj në programin e strehimit “Subvencionit të qirasë në tregun e lirë”.

Në këtë moment Z. Kastriot Shkjau largohet nga mbledhja, mbesin prezent 20 këshilltarë.

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Z. Edmond Gjeçaj-përfaqesues i zyrës mbrojtjes, përfshirjes dhe strehimit social, i cili relatton për këshilltarët se të tre familjet rezultojn se janë përfitues të mëparshëm në programin e strehimit “Subvencionit të qirasë në tregun e lirë”. Nga ana e komisionit të strehimit i ngritur me Vkb nr.80 datë 30.10.2023 për miratimin e ndryshimit të Vkb nr.33 datë 28.04.2023 për ngritjen e komisionit të strehimit, në mbledhjen e dates 12.02.2025, ka bërë shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur dhe kontratave të qirasë noteriale për të tre banorët e sipërpërmendur. Komisioni i strehimit ka vlerësuar se Z. Pjeter Zefi, Z. Paulin Bisha dhe Znj. Tone Pjetraj të jenë përfitues në programin e strehimit “Subvencionit të qirasë në tregun e lirë”. Vlera e subvencionit të qirasë llogaritet sipas VKM nr.362 datë 20.05.2019.

Z. Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z. Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 20 vota Pro zero kundër dhe zero abstenim.**

Këshilltarët që votuan Pro piken e pestë të rendit të ditës: (Franga Kola, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj, Roberto Trushi, Frano Prenga, Albina Livadhi, Ervis Shimaj, Rita Preçi, Ornela Lleshi, Mirela Vasija, Sanije Salja, Meliha Zyberaj, Mark Bisha, Martin Mardoda, Ermir Tahiri, Aleko Dodani, Marin Dodaj, Gjon Marku, Rregjinë Shelqetja, Vijoletë Markolaj)

Z. Ervis Shimaj lexon piken e gjashtë të rendit të ditës:

Projekt vendim për pranimin e të moshuara Znj. Lulë Nika në qendren e përkujdesit rezidencial për të moshuar “Besa” Barbullush.

Z. Ervis Shimaj fton për të relatuar për projekt vendimin Znj. Aurela Deda- përfaqesuese e zyrës mbrojtjes, përfshirjes dhe strehimit social, e cila relatton për këshilltarët se Znj. Lulë Nika ka paraqitur kërkesen pranë Sektorit të Shërbimit Social, Bashkia Vau Dejës, për sistemim në Qendrën e Përkujdesit Social për të Moshuar "Besa", Barbullush. Komisioni multidisiplinar i ngritur me urdherin e Kryetarit të Bashkisë Nr. 13 date 09.03.2023 "Per ngritjen e Komisionit Multidisiplinare per vlersimin e rasteve te personave qe kane nevoje per sherbime te kujdesit



shoqerore komunitare dhe rezidenciale publik dhe jopublik" ka bërë vlersimin e dokumentacionit. Nisur sa me siper e moshuara Lulë Nika ploteson kriteret.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 20 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim.**

Këshilltarët që votuan Pro piken e gjashtë të rendit të ditës: (Franga Kola, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj,Roberto Trushi, Frano Prenga, Albina Livadhi,Ervis Shimaj, Rita Preçi,Ornela Lleshi, Mirela Vasija,Sanije Salja, Meliha Zyberaj, Mark Bisha, Martin Mardoda,Ermir Tahiri,Aleko Dodani,Marin Dodaj, Gjon Marku, Rregjinë Shelqetja, Vijoletë Markolaj)

Z.Ervis Shimaj lexon piken e shtatë të rendit të ditës:

Projekt vendim për pranimin e të moshuares Znj.Ganxhe Lukani në qendren e përkujdesit rezidencial për të moshuar "Besa" Barbullush.

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar për projekt vendimin Znj.Aurela Deda- përfaqesuese e zyles mbrojtjes,përfshirjes dhe strehimit social, e cila relaton për këshilltarët se Znj.Ganxhe Lukani ka paraqitur kërkesen pranë Sektorit të Shërbimit Social, Bashkia Vau Dejës, për sistemim në Qendrën e Përkujdesit Social për të Moshuar "Besa", Barbullush. Komisioni multidisiplinar i ngritur me urdherin e Kryetarit të Bashkisë Nr. 13 date 09.03.2023 "Per ngritjen e Komisionit Multidisiplinare per vlersimin e rasteve te personave qe kane nevojë per sherbime te kujdesit shoqerore komunitare dhe rezidenciale publik dhe jopublik" ka bërë vlersimin e dokumentacionit. Nisur sa me siper e moshuara Znj.Ganxhe Lukani ploteson kriteret.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 20 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim.**

Këshilltarët që votuan Pro piken e tetë të rendit të ditës: (Franga Kola, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj,Roberto Trushi, Frano Prenga, Albina Livadhi,Ervis Shimaj, Rita Preçi,Ornela Lleshi, Mirela Vasija,Sanije Salja, Meliha Zyberaj, Mark Bisha, Martin Mardoda,Ermir Tahiri,Aleko Dodani,Marin Dodaj, Gjon Marku, Rregjinë Shelqetja, Vijoletë Markolaj)

Z.Ervis Shimaj lexon piken e tetë të rendit të ditës:

Projekt vendim për dhënien në përdorim me afat deri në 9 vjet për ndërtim/përdorim rruge për lidhjen e sipërfaqes së dhënë në përdorim, me rrjetin rrugor ekzistues me gjatësi 0.280 km rrugë kalimi në ngastra nr.98 në ekonominë pyjore Shosh 2:1.

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar Z.Mark Suli – inxhinjer, specialist pranë Drejtorise pyjeve, Bashkia Vau Dejës, i cili spjeron për këshilltarët se projekt vendimi i paraqitur është hartuar konform ligjit dhe se sipërfaqja që kërkohet për hapje/ndertim rruge është e çertifikuar në emër të



Bashkisë Vau Dejës. Dhënia në përdorim/ndertimin e rrugeve bazohet në piken nr.2 germa (c) dhe pika 7 te udhezimit nr.1 datë 09.06.2016 të Ministrit të Mjedisit “Për rregulat e procedurat e kërkimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”. Kjo sipërfaqe jepet në përdorim sipas procedurave të konkurrencimit publik.

Z.Ervis Shimaj spjeron për këshilltarët se për këtë projekt vendim është realizuar dëgjese publike me banorët e zonës me datë 19.02.2025 dhe se të pranishmit kishin shprehur dakortesi per projekt vendimin. Gjithashtu Z.Ervis Shimaj spjeron se është bërë një deklaratë me datë 24.02.2025 nga 6 banorë të zonës (z.Lulash Leku,z.Dedë Kapaj,Mirash Kapaj, z.Ndue Selja, z.Pjeter Leku, z.Lush Mali) të cilët deklarojnë se nuk kanë qenë të informuar për realizimin e dëgjesës publike të datës 19.02.2025 dhe se deklarojnë se nuk janë dakort me ndertimin e kësaj rruge dhe se nuk kanë qenë dakort as për dhënien me qira të këtyre sipërfaqeve toke pasi këto prona janë të hershme të parëve të tyre dhe se jemi kufitarë me njëri tjetrin.

Z.Ervis Shimaj sqaron këshilltarët lidhur me deklaratën e 6 banorëve se nga ana jonë me datë 21.01.2025 është bërë publik njoftimi për realizimin e këtij takimi, në faqen WEB të Bashkisë dhe gjithashtu njoftimi është afishuar pranë Njësisë Administrative Temal.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Z.Gjon Marku pyet: Lidhur me vendimet që janë marrë nga Këshilli Bashkiak për dhënie në përdorim, a janë paguar detyrimet kundrejt Bashkisë sepse këtë pyetje e kam bërë para disa muajsh?

Z.Ervis Shimaj sqaron se është e vërtetë që keni bërë këtë pyetje para disa muajsh por në mbledhjen pasardhëse është bërë raportimi nga Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave pranë Bashkisë Vau Dejës dhe ju nuk keni qenë prezent në atë mbledhje.

Z.Gjon Marku shprehet se nëse është kështu atëherë dakort.

Këshilltarët e tjerë nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 17 vota Pro;Z.Gjon Marku dhe Znj.Violetë Markolaj votuan kundra,2 (dy vota kundër) dhe Z.Marin Dodaj votoi abstenim1(një votë abstenim).**

Këshilltarët që votuan Pro piken e tetë të rendit të ditës: (Franga Kola, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj,Roberto Trushi, Frano Prenga, Albina Livadhi,Ervis Shimaj, Rita Preçi,Ornela Lleshi, Mirela Vasija,Sanije Salja, Meliha Zyberaj, Mark Bisha, Martin Mardoda,Ermir Tahiri,Aleko Dodani , Rregjinë Shelqetja,)

Z.Ervis Shimaj lexon piken e nëntë të rendit të ditës:

Projekt vendim për dhënien e ndihmes financiare të menjëhershme familjes së shtatasit Xhevahir Kol Gjoka, i dëmtuar nga erërat me intensitet të lartë të dt.12.01.2025, banorë i Bashkisë Vau Dejës.

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar Znj.Valjeta Nikaj-përgjegjëse e sektorit emergjencave e cila spjeron se Z.Xhevahir Gjoka, me datë 12.01.2025 si pasojë e erës me intensitet të lartë i është



zbuluar pjesërisht çatia e banesës, nga ku është bërë procesverbali i konstatimit nga komisioni i ngritur sipas urdherit të Kryetarit Bashkisë me nr.31 datë 22.01.2025, si dhe është bërë vlerësimi i dëmit, i cili arrin në vleren 96.000 lek.Vlerësohet të dëmshpërblehet në masen 50 % të dëmit total(48.000 lek).

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 18 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim.**

Z.Gjon Marku dhe Z.Marin Dodaj nuk marrin pjesë në votim.

Këshilltarët që votuan Pro piken e nëntë të rendit të ditës: (Franga Kola, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj,Roberto Trushi, Frano Prenga, Albina Livadhi,Ervis Shimaj, Rita Preçi,Ornela Lleshi, Mirela Vasija,Sanije Salja, Meliha Zyberaj, Mark Bisha, Martin Mardoda,Ermir Tahiri,Aleko Dodani, Rregjinë Shelqetja, Vjioletë Markolaj)

Z.Ervis Shimaj lexon piken e dhjetë të rendit të ditës:

Relacion spjegues mbi korrigjimin e Vkb nr.5, pika3,Vkb nr.6 pika 5 dhe Vkb nr.7 pika 3, datë 29.01.2025.

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar Znj.Valjeta Nikaj-përgjegjëse e sektorit emergjencave e cila spjegov se në muajin Janar 2025 janë marrë vendimet me nr.5,6 dhe 7 nga Këshilli Bashkiak Vau Dejës , por Institucioni i Prefektit Qarkut Shkodër ka konstatuar se duhet të bëhet korrigjimi konkretisht i pikave të vendimeve Vkb nr.5, pika3,Vkb nr.6 pika 5 dhe Vkb nr.7 pika 3, datë 29.01.2025, në mbledhjen më të parë të Këshillit Bashkiak sa i përket zbatueshmërisë së këtyre vendimeve, fondet duhet të merren nga buxheti i vitit 2025 dhe jo nga buxheti i vitit 2024 siç është cituar në vendimet e sipërcituara.Për këtë arsye kemi paraqitur pranë këshillit relacion spjegues me sqarimet përkatëse për vendimet e sipërcituara.

Institucioni i Prefektit Qarkut Shkodër ka autorizuar procedimin e mëtejshëm të vendimeve nr.5,6 dhe 7 të datës 29.01.2025.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime lidhur me realacionin e paraqitur.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Këshilltarët që shprehen dakortësi për sa u spjegua (Franga Kola, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj,Roberto Trushi, Frano Prenga, Albina Livadhi,Ervis Shimaj, Rita Preçi,Ornela Lleshi, Mirela Vasija,Sanije Salja, Meliha Zyberaj, Mark Bisha, Martin Mardoda,Ermir Tahiri,Aleko Dodani,Marin Dodaj, Gjon Marku, Rregjinë Shelqetja, Vjioletë Markolaj)

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët për të pyetur apo diskutuar te pika të ndryshme.

Këshilltarët nuk ngriten ndonjë shqetësim apo pyetje për këtë pikë të rendit të ditës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Këshilltarët nuk kishin diskutime tjera, Kryetari i Këshillit Bashkiak Vau Dejës e deklaroi të mbyllur mbledhjen e rradhës së muajit Shkurt 2025.

Mbajtësi i Protokollit

Sekretari Këshillit

Ardian ÇELEPIJA



Këshilltarët:

Ervis Shimoj
Mustriat Shkaka
Rita Praci
Franz Krenjo
Franz Pula
Meli Kopllanaj
Meliku Zyberi
Gjon Kambaj
Vlora Kostaj
Ermir Toliri
Leonora Prenja
Ornela Lleshi
Pregjime Shelqaja
Robert Trosh
Alëta Doshni
Allina Livdhi
Mark Bisha
Vangjel Selja
Martin Maroloda

Minelë Vasjati
Vjollëta Hodoqaj